



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 185/6 prot.

Tiranë, më 17.03.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 20, datë 17.03.2026

MBI

**PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË LIGJSHMËRISË SË PROCEDURËS SË
NDJEKUR NGA KOMISIONI I RISTRUKTURIMIT NË MINISTRINË E PUNËVE
TË BRENDSHME DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË
RREGULLUAR LIGJSHMËRINË NË RASTIN E TRANSFERIMIT TË
PËRHERSHËM TË NËPUNËSIT SHPËTIM ÇOKAJ**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përfundim të së cilit është vendosur transferimi i përhershëm i nëpunësit Shpëtim Çokaj,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresat nr. 185, datë 27.01.2026 “Ankesë për kundërshtim të aktit të transferimit” dhe nr. 185/4 prot., datë 26.02.2026 “Lidhur me ankesën e aktit të transferimit”, ka administruar informacionin e dërguar nga nëpunësi Shpëtim Çokaj, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në përmbajtje të së cilit ngrihen pretendime se, procedura

e ndjekur gjatë ristrukturimit të institucionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përfundim të së cilit, është vendosur transferimi i përhershëm i nëpunësit në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit”, në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR), institucion varësie i Ministrisë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është kryer në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në ligj, në pjesën që rregullojnë institutin e ristrukturimit në shërbimin civil.

Nëpunësi kundërshton aktin e transferimit të përhershëm të tij, duke parashtruar se pozicioni i mëparshëm i punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pas ristrukturimit është ende vakant dhe se, ekzistonin mundësi reale për sistemimin e tij sërish në atë pozicion ose në një pozicion të barasvlefshëm, brenda të njëjtit institucion.

Në këto kushte, nëpunësi ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera gjatë aplikimit të institutit të ristrukturimit në shërbimin civil.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësi Shpëtim Çokaj, ashtu si u evidentua më sipër, nëpërmjet shkresës nr. 185/1 prot., datë 02.02.2026 “Kërkesë dokumentacioni për verifikimin paraprak të informacionit të dërguar nga punonjësi Shpëtim Çokaj, në lidhje me transferimin për shkak të ristrukturimit të institucionit”, ka vënë në dijeni institucionin dhe njësinë përgjegjëse, DAP, për fillimin e verifikimit të procedurës së ristrukturimit, duke kërkuar njëherësh dokumentacionin në të cilën është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën e Departamentit të Administratës Publike, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 185/2 prot., datë 11.02.2026, si dhe me shkresën e Ministrisë së Punëve të Brendshme protokolluar me nr. 185/3 prot., datë 13.02.2026, janë dërguar pranë Komisionerit aktet përkatëse.

Nga këqyrja e dokumentacionit, rezultoi se nëpunësi Shpëtim Çokaj, me aktin nr. 3608, datë 08.06.2022, të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme, me klasë page **II-b**.

Në vijim, për shkak të ristrukturimit të institucionit, me aktin nr. 5918/64 prot., datë 20.10.2022, të Departamentit të Administratës Publike, është transferuar në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Regjistrave”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme, me klasë page **II-b**, ndërkohë që me urdhër të titullarit, për nevoja të institucionit, kryente detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Më tej, me aktin nr. 21/44 prot., datë 03.02.2025, të DAP, është transferuar për shkak të ristrukturimit në të njëjtin pozicion (*Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve*), tashmë me klasë page **II-1** dhe me strukturë të pandryshuar.

Nëpunësi ka vijuar ushtrimin e kësaj detyre deri në momentin e fillimit të procesit të ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas urdhrit nr. 224, datë 04.12.2025, të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Punëve të Brendshme*”.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; VKM nr. 125, datë 17.02.2016 “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”; udhëzimin nr. 01, datë 01.03.2016, të DAP “*Për krijimin, funksionimi e dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*” i ndryshuar, Komisioni i Ristrukturimit, ka shqyrtuar mundësitë e sistemimit të nëpunësve të prekur nga ristrukturimi, e në këtë kuadër, duke iu referuar përshkrimeve të punës dhe kriterëve të posaçme, ka propozuar mes të tjerash transferimin e përhershëm të nëpunësit Shpëtim Çokaj, në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit*”, në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR), institucion varësie i Ministrisë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ky propozim është mbështetur në argumentin se drejtoria ku ai ushtronte detyrën është riemërtuar dhe se janë ndryshuar kriteret e posaçme të pozicionit, konkretisht kriteri arsimor.

Mbi këtë propozim, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr. 388/107 prot., datë 22.01.2026 “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, me të cilin është vendosur transferimi për shkak të ristrukturimit për nëpunësit Shpëtim Çokaj, në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit*”, në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural – klasa e pagës **II-2**.

Brenda afatit ligjor, nëpunësi e ka kundërshtuar këtë akt, duke kërkuar sistemimin në një pozicion të shërbimit civil brenda të njëjtit institucion dhe me të njëjtën kategori page.

Nga analiza e dokumentacionit rezulton se procesi është formalish i rregullt, pasi janë ndjekur hapat proceduralë të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore gjatë procesit të ristrukturimit.

Megjithatë, në aspektin material, evidentohen problematika thelbësore në zbatimin e dispozitave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar.

Konkretisht, në pikën 1, të këtij neni, parashikohet se:

“1. Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori;

.....”.

Nga analiza e dokumentacionit rezulton se, drejtoria ku ushtronte detyrën nëpunësi është riemërtuar dhe riorganizuar, por nuk provohet ndryshimi substancial i funksioneve, objektivave dhe përgjegjësi të pozicionit të punës.

Në vijim të arsyetimit, vërehet se ndryshimi i emërimit dhe strukturës së drejtorisë nuk është shoqëruar me ndryshime thelbësore në misionin, qëllimin dhe detyrat kryesore të pozicionit. Përkundrazi, qëllimi i pozicionit dhe detyrat kryesore mbeten të njëjta ose shumë të ngjashme, ndërsa ndryshimi i kriterit arsimor është kufizuar pa një arsyetim të plotë funksional.

Nga ana tjetër, në një rast ristrukturimi, përshkrimi i punës, si institut i rëndësishëm i ligjit për nëpunësin civil, duhet të reflektojë realisht ndryshimet organizative dhe funksionale. Në këtë rast, nuk provohet se kanë ndryshuar objektivat dhe detyrat kryesore të pozicionit, ndërsa kriteret arsimore janë ngushtuar në mënyrë të pajustificuar, pavarësisht natyrës së punës në fushën e teknologjisë së informacionit.

Konkretisht, nga verifikimi i formularit të përshkrimit të punës, konstatohet se qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës në të dy rastet, konsiston në administrimin dhe përmirësimin e sistemeve informatike.

Po kështu edhe detyrat kryesore janë në thelb të njëjta dhe nuk konstatohet ndryshim thelbësor i natyrës së funksionit.

Në këto kushte, ndryshimi i kriterit arsimor pa një ndryshim real të funksioneve të përcaktuara në rubrikën “*Kërkesa të posaçme*” të përshkrimit të pozicionit të punës, bie në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, kur fusha e formimit arsimor në drejtorinë e re përfshin vetëm një opion: diplomë në Inxhinieri elektronike; ndërsa në drejtorinë e mëparshme, “*Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave*”, fusha e formimit arsimor ishte më e gjerë, ku përveç Inxhinieri elektronike, përshkruan Shkenca kompjuterike/Inxhinieri informatike /Informatikë /Informatikë elektronike. Kjo përfshirje e gjerë e arsimit është e kuptueshme nisur nga natyra e punës së këtyre drejtorive në fushën e informatikës.

Po ashtu, transferimi i nëpunësit në një institucion tjetër nuk është në përputhje me rendin e përparësisë së përcaktuar në ligj, në kushtet kur në institucionin fillestar ekzistojnë pozicione të lira. Sipas pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësit civil*”, i ndryshuar,

“2. Transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me precedencë, sipas kësaj renditjeje:

- a) *në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar;*
- b) *.....”*

Nga aktet e administruara nuk rezulton të jetë kryer një arsyetim i plotë dhe i dokumentuar për pamundësinë e sistemimit të nëpunësit brenda institucionit, fakt që përbën shkelje të

detyrimet për arsyetim të aktit administrativ, të parashikuar në nenin 100, të Kodit të Procedurave Administrative.

Një tjetër element problematik është edhe ulja e klasës së pagës për nëpunësin (nga II-1 në II-2), e cila bie në kundërshtim me parimin e ruajtjes së statusit të nëpunësit civil, që rrjedh nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar, si dhe me parimin e stabilitetit të marrëdhënies së shërbimit civil.

Në interpretim të këtij neni, ruajtja e kategorisë së nëpunësit civil nuk kufizohet vetëm në nivelin drejtues, por përfshin edhe elementët thelbësorë të statusit, përfshirë klasën e pagës. Çdo interpretim i kundërt do ta kthente transferimin për shkak ristrukturimi në një instrument penalizues, në kundërshtim me qëllimin e ligjit.

Nisur nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se transferimi i përhershëm i nëpunësit Shpëtim Çokaj, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit”, në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, kategoria e pagës II-2, është i paligjshëm, pasi nuk janë respektuar rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, për transferimin e përhershëm për shkak të ristrukturimit, prandaj në bazë të nenit 109, germa c), si dhe nenit 113/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, vetë organi publik duhet të vendosë anulimin e transferimit të përhershëm të këtij nëpunësi, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit”, në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës II-2, dhe të shqyrtojë mundësitë e sistemit të tij në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke patur për bazë rregullat, të cilat u evidentuan në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe në neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të paralajmërojë institucionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për të rikthyer situatën e ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, duke vepruar si më poshtë:
 - Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse DAP, të vendosë anulimin e pjesshëm të procesit të ristrukturimit për pjesën e transferimit të përhershëm për nëpunësin Shpëtim Çokaj, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së

Teknologjisë së Informacionit”, në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural – klasa e pagës II-2, si dhe aktit të emërimit të nxjerrë në vijim, në këtë pozicion pune.

- Të kryhet një rivlerësim i plotë i mundësive për sistemimin e nëpunësit *Shpëtim Çokaj*, në institucionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësit civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016 “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, në një pozicion pune brenda të njëjtës kategori ku nëpunësi plotëson kriteret e posaçme, duke ndjekur hapat e parashikuara në pjesën arsyetuese të relacionit.
 - Njësia e Burimeve njerëzore pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, të marrë masat dhe të ndjekë procesin për plotësimin e detyrës së mësipërme, brenda afatit të lënë në këtë vendim.
2. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **15** ditë nga marrja dijani e vendim.
 3. Me kalimin e këtij afati, institucioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *Shpëtim Çokaj*.
 5. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)